

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

---

**AKTIVITETET PROJEKTUESE  
NGA MATEMATIKA**  
*NË ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL*

Materialin e përgatitën:  
KATICA SPASOVSKA-BINÇEVA  
GOCE SHOPKOSKI  
Sipas materialit bazë

shtator, 2005  
Shkup

Hyrje:

Aktivitetet projektuese në tërësi, por edhe aktivitetet projektuese nga matematika paraqesin segment të posaçëm në arsimin e mesëm profesional. Vendosija e tyre del nga nevoja e modernizimit të arsimit dhe realizimit të orëve të lira në shkollë, gjegjësisht kyçja e nxënësit në punë hulumtuese dhe mundësia që ta tregojë diturinë dhe interesin e vet, gjegjësisht kyçja e nxënësit në punë hulumtuese dhe mundësia që të tregojë diturinë dhe interesin e tij. Këto paraqesin aktivitet të ri arsimor, në mënyrë të re të punës së nxënësit dhe arsimtarit. Me ato vendoset komunikim dhe bashkëpunim më i mirë në relacionin arsimtar – nxënës. Me këtë segment hapet hapësirë adekuate në punën edukativo-arsimore, në të cilën nxënësi ka mundësi t'i shprehë afinitetet, nevojat dhe aftësitë e veta. Njëherësh, me aktivitetet projektuese mundësohet inovimi i punës profesionale dhe didaktiko-metodike të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollë.

Aktivitetet projektuese nga matematika vendosen nga viti shkollor 2005/2006. Këto nuk janë lëndë të reja mësimore, por janë projekte nga problematika e caktuar, të cilën vetë nxënësit në mënyrë individuale ose grupe e zgjedhin dhe i realizojnë me ndihmën e arsimtarit. Këto realizohen me mësim-mentore, me çrast arsimtari ka fond të caktuar të orëve për mësimin dhe aftësimin e nxënësit për punë të pavarur ose punë ekipore. Duhet theksuar se këto aktivitete janë në funksion të provimit përfundimtar.

### Qëllimet e aktiviteteve projektuese

Me realizimin e aktiviteteve projektuese nxënësi duhet të:

- fitojë njohuri dhe dituri të zgjeruara e të thelluara nga lëmia për të cilën është përcaktuar;
- aftësohet për zbulim dhe hulumtim në grup ose ekip;
- tregojë afinitetin, potencialin dhe talentin e tij drejtë lëmisë së përcaktuar;
- arrijë sukses për: punë të pavarur, shfrytëzim të literaturës së pavarur, internet dhe burimeve tjera të informatave;
- të përforcojë karakteristika pozitive të personalitetit të tij ( vetëbesim, dëshirë, qëndrueshmëri, parim, saktësi etj)
- të zhvillojë aftësi për punë ekipore, prezantim dhe komunikim me mjedisin lokal;

- t'i zhvillojë dhe t'i përmbushë nevojat punuese, kulturore, etike dhe estetike për mjedisin ku shkollohet dhe më gjërë.

Aktivitetet projektuese nga matematika mund të realizohen në secilin nga katër vitet e shkollimit edhe atë: në vitin e I, II, III dhe IV nga 70 orë për një lëmi.

Për t'u organizuar aktivitetet projektuese nga matematika, e domosdoshme është që shkolla të formojë grup të nxënësve që kanë afinitet nga matematika. Në kuadër të këtij grupi, arsimtari i cakton intereset e nxënësve për temat dhe projektet konkrete nga matematika, në të cilat ata dëshirojnë të hulumtojnë dhe formojnë grupe përkatëse projektuese (5-6 nxënës). Për secilin nga këto grupe sëbashku me nxënësit i definojnë titujt e projekteve.

Nxënësit mund të përpunojnë më shumë projekte gjatë vitit shkollor nga e njëjta lëmi.

#### Disa karakteristika të aktiviteteve projektuese

- ❖ Aktivitetet projektuese nga matematika janë në korelacion me :
  - mësimin e detyrueshëm
  - mësimin zgjedhor dhe
  - aktivitetet projektuese nga lëmitë tjera
- ❖ Me aktivitetet projektuese nxënësit kanë të bëjnë me:
  - zgjedhjen e temës
  - metodologjinë e hulumtimit, përpunimit dhe prezantimit të rezultateve nga hulumtimi
- ❖ Aktiviteti projektues ka karakter zhvillues dhe periudhë karakteristike.
- ❖ Struktura e aktivitetit projektues i posedon elementet vijuese:
  - përmbajtjet – tema potenciale për projekte;
  - qëllime- qëllim të përgjithshëm dhe të veçanta;
  - aktivitete të planifikuara;

- kushte për realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- organizimi dhe realizimi i aktiviteteve;
- kriteret, mjetet dhe mënyra e evaluimit të rezultateve nga hulumtimi.

### Si t'i planifikojmë dhe realizojmë aktivitetet projektuese nga matematika ?

#### Roli i arsimtarit

Arsimtari që realizon aktivitet projektues duhet në hollësi t'i njoftojë nxënësit:

- për qëllimet e tija, organizimin dhe mënyrën e realizimit;
- se realizimi i aktiviteteve projektuese për çdo nxënës është i detyrueshëm;
- se arsimtari e planifikon dhe programon aktivitet projektues sipas nevojave dhe interesimit të nxënësve;
- se arsimtari ka rolin e projekt – menaxherit (mentor, konsultant dhe trajnues);
- për obligimin e vet ta kontrollojë dhe nënshkruajë (lejojë) portfolion e nxënësit;
- bën evidencën për realizimin e aktiviteteve (në orë);
- bën raport për punën e çdo nxënësi.

*Aktivitetet projektuese nga matematika:*

- organizohen në kuadër të orëve të lira në shkollë, në kohë të preferueshme për nxënësit;
- nuk realizohen sipas orarit javor të paraleles;
- nuk vlerësohen (as me numër e as me notim përshkrues)
- çdo nxënës është i detyrueshëm t'i realizojë sipas zgjedhjes së tij, në volumin e paraparë gjatë vitit mësimor.

#### Roli i nxënësit

Nxënësi

- lirshëm zgjedh aktivitet projektues sipas afiniteteve dhe dëshirave të veta;
- aktivitetet e zgjedhura (nga një ose më shumë lëmi) domosdo i realizon në kohëzgjatjeje prej 70 orëve për një vit mësimor;

- punon në projektin hulumtues, në grup ose në bashkëpunim me arsimtarin;
- bën portfolio dhe në të i shënon aktivitetet e tija;
- është i detyrueshëm të bashkëpunojë me anëtarët e tjerë në grup;
- për çdo fazë të projektit, si dhe për projektin në tërësi, nxënësi është i detyrueshëm të përpilojë material dëshmuës (prezentim, grafikë nga lloji i ndryshëm, CD, disketë, film, veb-sajd, promovim, prezantim, manifestim, gazetë muri, ekspozitë etj) në kuadër të kohës në disponim për realizimin e projektit.
- me dinjitet e prezanton shkollën në manifestime.

Nxënësi, i cili nuk ka arritur t'i realizojë aktivitetet projektuese të cilat lirshëm i ka zgjedhur, sipas përmbajtjes dhe vëllimit të paraparë, këtë duhet ta bëjë deri në fillim të vitit shkollor vijues që të mund të marrë dëftesë për vitin e kryer.

Aktivitetet projektuese i programojnë shkollat, përkatësisht arsimtarët, bashkëpunëtorët profesional (pedagogë, psikologë, sociologë etj) dhe nxënësit, kurse sipas nevojës së treguar mund të kërkohet ndihmë edhe nga Byroja për zhvillimin e arsimit dhe institucionet tjera nga mjedisi lokal të interesuara për bashkëpunim reciprok.